



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 21

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 16 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 22, datë 30.1.2018	Mbi ankimin e shoqërisë OST sh.a. në lidhje me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 28.12.2017, “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018”..... 1337
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 30.1.2018	Mbi miratimin e “Rregullores për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror”..... 1338
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 24, datë 30.1.2018	Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të tregtimit të gazit natyror..... 1344
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 25, datë 30.1.2018	Mbi miratimin e licencës tip në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.. 1352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 30.1.2018	Mbi licencimin e shoqërisë Energji Ashta sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 1361
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 30.1.2018	Mbi licencimin e shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga: HEC Llënga 1, me fuqi 1730 kw; HEC Llënga 2, me fuqi 300 kw; dhe HEC Llënga 3, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw..... 1362
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 28, datë 30.1.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Luçente Koncesionare sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Spatharë, me fuqi 1038 kw..... 1363
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29, datë 30.1.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Rej Energy sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 177, seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012..... 1365

**VENDIM****Nr. 22, datë 30.1.2018****MBI ANKIMIN E SHOQËRISË OST SHA
NË LIDHJE ME VENDIMIN E BORDIT
TË ERE-s NR. 210, DATË 28.12.2017, “PËR
MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT
TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA OST SHA
PËR VITIN 2018”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin “Mbi ankimimin e shoqërisë OST sh.a., në lidhje me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 28.12.2017, “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018”, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e bordit nr. 210, datë 28.12.2017, ka miratuar tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018.

- ERE, me shkresën me nr. 828 prot., datë 29.12.2017, i ka bërë me dije OST sh.a., datë 5.1.2018, vendimin e bordit nr. 210, datë 28.12.2017, “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018”.

- OST sh.a., me shkresën nr. 93/1 prot., datë 11.1.2018 (protokolluar në ERE me nr. 6/1, datë 15.1.2018), kërkoi rishikimin dhe korrigjimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 210, datë 28.12.2017, “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për vitin 2018”.

- Në vijim, OST sh.a., me shkresën nr. 93/2 prot., datë 22.1.2018, dërgoi në ERE një përsëritje të pretendimeve të saj, të cilat shoqëria i kishte adresuar në shkresën nr. 93/1 prot., datë 11.1.2018, në formën e një kërkesë për informacion dhe jo një kërkesë për plotësim të kërkesës për rishikim.

- OST sh.a. pretendon se në vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 28.12.2017, nuk

është përfshirë shlyerja nga ana e OSHEE sh.a. e detyrimeve të prapambetura ndaj OST sh.a., me qëllim shlyerjen e kredive nga kjo e fundit, ashtu siç parashikohet në vendimin e bordit të ERE-s nr. 111, datë 1.7.2016, “Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016”, si dhe vendimin nr. 190, datë 22.12.2016, “Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit nr. 13, datë 16.2.2016, vendimit nr. 128, datë 29.7.2016 të Bordit të ERE-s deri më 31.3.2017”, ku përcaktohet se: OSHEE sh.a., përveç shlyerjes së detyrimeve korente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a., nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a. dhe KESH sh.a.”.

- Në lidhje me sa më sipër, ERE është shprehur në pikën 5, të vendimit nr. 211, datë 28.12.2017, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”, në lidhje me këtë çështje, duke e adresuar shlyerjen e detyrimeve korente nga OSHEE sh.a.

- OST sh.a. shpreh mosdakordësinë në lidhje me arsyetimin e ERE-s, në vlerësimin e aplikimit për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018, OST sh.a., ku kjo e fundit ka parashikuar një sërë shpenzimesh ku përfshihen kapacitetet rezervë të rregullimit dhe ridispeçerimit që kapin shifrën prej 1,233 milionë lekësh kundrejt 100 milionë lekësh të shpenzuara për periudhat paraardhëse.

- Në lidhje me sa më sipër e në përgjigje të shkresës së ERE-s nr. 758/2 prot., OST sh.a. dërgoi në ERE informacion të përgjithshëm në lidhje me vlerën e shpenzimit për vitin 2017 dhe ERE e njohu këtë shpenzim me vlerën e kërkuar nga OST sh.a., për shumën 1,233 milionë lekë, me kushtin që ky shpenzim, nëse nuk realizohet, do të axhustohet në periudhën pasardhëse, në mënyrë që t'i krijohet të ardhura të mjaftueshme shoqërisë për shpenzimin e parashikuar.



- ERE, në llogaritjen e tarifave, merr në konsideratë nivelin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të miratuara prej saj, kundrejt atyre të realizuara (në referim të pasqyrave financiare të audituara dhe të dhënave të raportuara nga i licencuari në formë zyrtare), si dhe sasinë e energjisë elektrike të transmetuar gjatë periudhave të mëparshme rregullatore (2015–2016), e cila ka impakt në tarifën mesatare të realizuar.

- OST sh.a. pretendon se aplikimi për tarifën e transmetimit për vitin 2018, është kryer duke u mbështetur në “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, të miratuar nga ERE. Sipas kësaj metodologjie, OST sh.a., në aplikimin e saj ka kërkuar nga ERE të miratojë sipas varianteve respektive:

1. Tarifën për kapacitet;

2. Tarifën për energji;

3. Tarifën mesatare të transmetimit të energjisë.

- Për sa më sipër rezulton se është i paqartë pretendimi i shoqërisë në lidhje me sigurimin e të ardhurave dhe deri në një plotësim të përlllogaritjeve, ERE vendos të miratojë, ashtu si dhe gjatë periudhave paraardhëse rregullatore, një tarifë mesatare transmetimi: kosto totale/energji elektrike.

- Legjislacioni në fuqi parashikon që: “Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin, në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”. OST sh.a. rezulton se nuk ka paraqitur asnjë provë të re dhe asnjë dokument i cili mund të konsiderohet një provë e re.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë OST sh.a., për rishikimin dhe korrigjimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 210, datë 28.12.2017, “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018”.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 23, datë 30.1.2018

MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 76, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e “Draftrregullores për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 76, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE miraton rregulloren për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.

- ERE, me vendimin e bordit nr. 192, datë 24.11.2017, filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draftrregullores për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.

- ERE, më shkresën nr. 100/60 prot., datë 30.11.2017, publikoi për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit, duke filluar nga data 1 dhjetor 2017. Me anë të këtij njoftimi, u ftuan të gjitha palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve.

- ERE, me shkresën nr. 774 prot., datë 6.12.2017, dërgoi “Draftrregulloren për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: Albgaaz sh.a., Albpetrol sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.



- Në përfundim të afatit të përcaktuar për marrjen e komenteve të të gjitha palëve të interesit, mbi sa parashikuar në draftin e kësaj rregulloreje, rezultoi që nuk ka pasur komente.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Këto rregulla përcaktojnë kushtet dhe procedurat për ndryshimin e furnizuesve të gazit natyror, të cilët furnizojnë klientin në bazë të një kontrate për furnizim, si dhe të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve të gazit natyror, klientit dhe operatorit të sistemit, në kuadër të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje janë vendosja e rregullave për palët në kontratë, për ndryshimin e furnizuesit të gazit natyror dhe garantimin e së drejtës së klientit për të kërkuar ndryshimin e furnizuesit.

Neni 3 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 76, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 4

Përkufizimet

Disa nga shprehjet e përdorura në këto rregulla do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Furnizuesi i ri”, furnizuesi me të cilin klienti dëshiron të lidhë një kontratë shitjeje në fillim të procedurës për ndërrimin/ndryshimin e furnizuesit.

“Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)” është personi juridik, i cili kryen funksionin e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen me sisteme të tjera, si edhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit.

“Operator i Sistemit të Transmetimit (OST)” është personi juridik, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit.

“Furnizuesi”, subjekti që furnizon (shet dhe i rishet gazin) klientin në bazë të një kontrate furnizimi.

“Furnizuesi aktual”, furnizuesi që furnizon klientin në fillim të procedurës së ndërrimit të furnizuesit.

“Pikë lidhjeje” është pika e lidhjes fizike të një përdoruesi me rrjetin e shpërndarjes.

“Qendra e gazit” do të quhet sistemi në të cilin gazi hyn në pikat e hyrjes dhe del në pikat e daljes, duke regjistruar të dhëna të detajuara mbi të.

Termat e tjerë të përdorur në këto rregulla do të kenë të njëjtin kuptim si ato të referuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, më poshtë “ligji”.

Neni 5

Kushtet e përgjithshme

Procedura e ndryshimit të furnizuesit të gazit natyror nuk do të ketë kosto për klientin.

E drejta e ndryshimit të furnizuesit u jepet vetëm klientëve që kanë të drejtë të zgjedhin lirisht



furnizuesin e tyre në pajtim me ligjin, rregulloret që rregullojnë kushtet për furnizimin me gaz natyror dhe kontratën përkatëse të shitjes.

Klienti dhe çdo palë e tretë që e bën interesin e tij ligjor të besueshëm, ka të drejtë të informohet për procedurën që ndiqet për ndryshimin e furnizuesit nga furnizuesi aktual.

Neni 6

Procedura e ndryshimit të furnizuesit me kërkesë të klientit

6.1 Procedura e ndryshimit të furnizuesit sipas aplikimit të klientit, siç përshkruhet në këtë nen, do të fillojë në të gjitha rastet kur një furnizues, p.sh., furnizuesi publik vepron ose si një furnizues i ri, ose si furnizues aktual.

Procedura e ndryshimit të furnizuesit mund të kryhet vetëm me një furnizues në të njëjtën kohë.

Procedura e kalimit të furnizuesit nuk duhet të kalojë më shumë se 3 javë pas datës së dorëzimit të një aplikimi të vlefshëm.

6.2 Procedura e ndryshimit të furnizuesit fillon me iniciativë të një klienti, duke dorëzuar një kërkesë të një furnizuesi i ri.

Klienti që ka lidhur një kontratë furnizimi me afat të caktuar, duhet të dorëzojë aplikimin jo më vonë se 3 javë para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës së furnizimit në fuqi.

6.3 Aplikimi për ndryshimin e furnizuesit duhet të dorëzohet nga një klient në dy kopje, në formë të shkruar, të njohur nga një furnizues i ri. Në veçanti, forma duhet të përfshijë:

a) emrin e biznesit, selinë, numrin e identifikimit, NUIS-in e klientit (për personat juridikë dhe sipërmarrësit), përkatësisht emri dhe mbiemri, adresa dhe numri identifikues personal (për personat fizikë);

b) numrin e identifikimit të pikave të matjes, siç jepet në bazën e të dhënave të pikave matëse [(Në bazën e të dhënave të matjes (më poshtë “baza e të dhënave”)];

c) kapacitetin e aprovuar në pikën e matjes;

d) datën e dorëzimit të aplikimit;

e) emrin e biznesit të furnizuesit aktual dhe periudhën e vlefshmërisë së kontratës së lidhur ndërmjet klientit dhe furnizuesit aktual.

6.4 Përveç aplikimit të përmendur në pikën 6.3 të këtij neni, klienti duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme në dy kopje:

a) një deklaratë në formë të shkruar të lëshuar nga furnizuesi aktual, me qëllim të fillimit të procesit të ndryshimit të furnizuesit, e cila nuk duhet të lëshohet më herët se shtatë ditë para datës së paraqitjes së kërkesës, me të cilën furnizuesi aktual konfirmon se detyrimet e ndërsjella në aspektin financiar dhe të furnizimit, janë zgjidhur ndërmjet furnizuesit dhe klientit në ditën e lëshimit të deklaratës;

b) deklaratë me të cilën klienti përfundon kontratën me furnizuesin aktual, përpara afatit të përfundimit normal të kohëzgjatjes së saj, duke deklaruar arsyen e ndërprerjes së kontratës me furnizuesin aktual, me qëllim ndryshimin e furnizuesit. Përfundimi i kontratës si më sipër do të konsiderohet në datën e matjes së të dhënave që janë siguruar nga operatori i sistemit në pikën e matjes;

c) një deklaratë me shkrim në datën e përfundimit të kontratës së shitjes, të dorëzuar nga klienti sipas pikës 6.2, paragrafi 2, të këtij neni;

d) pëlqimin e klientit për përdorimin e të dhënave personale dhe të dhënave të tjera të fituara gjatë procesit të ndryshimit të furnizuesit vetëm për këto qëllime.

6.5 Pas pranimit të aplikimit për ndërprerjen e furnizimit nga furnizuesi aktual, furnizuesi i ri do të shqyrtojë vlefshmërinë e tij. Sapo furnizuesi i ri të pranojë aplikimin e përmendur në pikën 6.2, paragrafi 2, ai gjithashtu do të shqyrtojë afatin kohor të aplikimit.

Nëse furnizuesi i ri e gjen aplikimin të pakuptueshëm ose jo të plotë brenda tri ditëve nga marrja, ai do të ftojë klientin të korrigjojë të metat në kohën e duhur, duke paralajmëruar klientin për pasojat që rrjedhin nga mosrespektimi i kërkesës.

Nëse kërkesa e klientit nuk përputhet me ftesën, furnizuesi i ri duhet të informojë klientin për mosrespektimin e kushteve për ndryshimin e furnizuesit brenda tetë ditëve pas skadimit të afatit të dhënë klientit.

6.6 Tri ditë pas marrjes së një aplikimi të vlefshëm, furnizuesi i ri do të lidhë një kontratë shitjeje me klientin, e cila do të zbatohet që nga data kur operatori i sistemit i siguron të dhënat e matjes për pikën e lidhjes të klientit (në vijim “data e kalimit të furnizuesit”).



Në ditën vijuese të punës që nga dita e matjes, furnizuesi i ri duhet t'ia dorëzojë operatorit të sistemit një kopje aplikimi me të dhënat e referuara në pikën 6.4 të këtij neni.

6.7 Brenda tri ditëve nga data e pranimi të kërkesës, operatori i sistemit do të kontrollojë shënimet dhe bazën e të dhënave për pikën e matjes, në mënyrë që të kontrollojë saktësinë e të dhënave të aplikacionit.

Pasi operatori i sistemit të konstatojë se të gjitha të dhënat e nevojshme për ndryshimin, janë të sakta, duhet ta përcjellë deklaratën e klientit, të përmendur në pikën 6.4, te furnizuesi aktual, jo më vonë se ditën e punës në vijim.

6.8 Nëse furnizuesi aktual paraqet ankesë ndaj operatorit të sistemit, operatori i sistemit duhet të informojë klientin dhe furnizuesin e ri për mosrespektimin e kushteve për ndryshimin e furnizuesit.

6.9 Operatori i sistemit duhet të ofrojë të dhënat e matjes për pikën e lidhjes së klientit, për të cilën procedura është nisur pas një kërke. Për konsumatorin e përmendur në pikën 6.2, paragrafi 2, të këtij neni, operatori i sistemit duhet të ofrojë të dhënat e matjes për pikën e matjes në qendrën e gazit.

6.10 Nëse, gjatë procesit të ndryshimit të furnizuesit, deri në ditën e ndryshimit të furnizuesit në kuptim të këtyre rregullave, operatori i sistemit merr disa aplikime nga furnizues të ndryshëm për të njëjtën pikë lidhjeje, d.m.th. pika për të njëjtin klient, operatori i sistemit do të ftojë konsumatorët brenda tri ditësh pas ditës së dorëzimit të njoftimit për të vendosur se cili aplikim i paraqitur do të procedohet, duke e paralajmëruar atë për pasojat e mosrespektimit të afatit.

Nëse klienti nuk bie dakord me ftesën, operatori i sistemit duhet të informojë klientin dhe të gjithë furnizuesit të cilët kanë paraqitur një aplikim të tillë, për mospërputhjen me kushtet për ndryshimin e furnizuesit.

6.11 Nëse, duke respektuar kërkesën e përcjellë, siç referohet në pikën 6.6, paragrafi 2, operatori i sistemit, duke kontrolluar regjistrimet dhe bazën e të dhënave, përcakton pasaktësi të të dhënave në aplikim, ai duhet të informojë furnizuesin e ri brenda tri ditëve për këto pasaktësi. Pas pranimi të njoftimit nga operatori i sistemit, furnizuesi i ri do të ftojë klientin të modifikojë të dhënat në kërkesë brenda tri ditëve nga dita kur klienti është ftuar të

modifikojë të dhënat e paraqitura në aplikim, duke përcaktuar një afat kohor të përshtatshëm për rishikimin.

Nëse klienti e rishikon kërkesën brenda afatit të caktuar, furnizuesi i ri do të përcjellë aplikimin e rishikuar tek operatori i sistemit brenda tri ditëve nga marrja e tij, ndërsa operatori i sistemit duhet të veprojë plotësisht në përputhje me pikat 6.7–6.9 të këtij neni.

Nëse klienti nuk i rishikon të dhënat brenda afatit të caktuar edhe pse ai është ftuar ta bëjë këtë, furnizuesi i ri duhet të informojë klientin për mosrespektimin e kushteve për ndryshimin e furnizuesit brenda afatit kohor jo më shumë se tri ditë pas paraqitjes së aplikimit.

6.12 Të dhënat e matjes nga pika e lidhjes, p.sh. pikat e matjes që sigurohen nga operatori i sistemit, në përputhje me pikën 6.9 të këtij neni, duhet të përfshijnë datën së cilës ata i referohen, që konsiderohet të jetë dita e ndryshimit të furnizuesit.

6.13 Në ditën kur furnizuesi është ndryshuar dhe do të hyjë në fuqi kontrata e shitjes, e lidhur ndërmjet klientit dhe furnizuesit të ri, kontrata e shitjes me furnizuesin aktual do të pushojë efektet juridike dhe përgjegjësia e balancimit për pikën e lidhjes do të transferohet te furnizuesi i ri.

Neni 7

Procedura e ndryshimit të furnizuesit në rast të kalimit te furnizuesi i mundësisë së fundit

7.1 Në rast të kalimit te furnizuesi i mundësisë së fundit për shkak të falimentimit ose likuidimit të furnizuesit aktual, dita e ndryshimit të furnizuesit do të konsiderohet dita kur efektet ligjore të fillimit të falimentimit (procedurat e likuidimit) bëhen efektive.

Furnizuesi aktual është i detyruar të informojë konsumatorët, operatorët e sistemit dhe furnizuesin e mundësisë së fundit për ditën kur pasojat ligjore të falimentimit, d.m.th. likuidimi, janë bërë efektive, pa vonesë, jo më vonë se tetë ditë pas ditës kur ai u bë i vetëdijshëm për pamundësinë e furnizimit të klientëve.

Brenda tetë ditësh pas dorëzimit të njoftimit nga furnizuesi aktual, operatori i sistemit duhet të ofrojë të dhëna të matjes për pikën e lidhjes dhe t'ia dorëzojë ato klientit, furnizuesit aktual dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.



7.2 Në rast se licenca e mbajtur nga furnizuesi aktual skadon, shfuqizohet ose hiqet përgjithmonë, pa vonesë, jo më vonë se tetë ditë përpara se vendimi mbi skadimin, shfuqizimin ose revokimin e përhershëm të licencës të bëhet përfundimtar, ERE do të informojë të gjithë operatorët e sistemit, furnizuesin aktual dhe furnizuesin e mundësisë së fundit për ditën në të cilën ndryshimi i furnizuesit hyn në fuqi.

Dita e ndryshimit të furnizuesit është dita kur vendimi i ERE-s për përfundimin, për ndërprerjen ose për revokimin e përhershëm të licencës bëhet përfundimtar.

Operatori i sistemit duhet të sigurojë të dhënat e matjes për pikën e lidhjes, brenda tetë ditësh pas paraqitjes së njoftimit të ERE-s dhe informimit të klientit, për licencën e furnizuesit që përfundon, që është anuluar ose revokuar dhe kalimin e tyre te furnizuesi i mundësisë së fundit.

7.3 Klienti i cili ka të drejtën e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që nuk ka gjetur furnizues të ri me përfundimin e kontratës së mëparshme, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë te furnizuesi i mundësisë së fundit, për sigurimin e shërbimit brenda 60 ditëve, gjatë të cilave ai ka të drejtë për t'u furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Ky afat fillon nga data kur kontrata e shitjes me furnizuesin e mëparshëm pushon së qeni e vlefshme, përveç rasteve kur kontrata e shitjes pushon së qeni e vlefshme për shkak të mospagesës nga klienti.

Kërkesa duhet të dorëzohet nga klienti në formën e shkruar, të pranuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit, duke përfshirë në veçanti:

a) emrin e biznesit, selinë, numrin e identifikimit, NUIS-in (për personat juridikë dhe sipërmarrësit); përkatësisht: emrin dhe mbiemrin, adresën dhe numrin identifikues personal (për personat fizikë);

b) numrin identifikues së bazës së të dhënave të pikave matëse;

c) datën e paraqitjes së kërkesës;

d) miratimin e konsumatorit për përdorimin e të dhënave personale dhe të dhënave të tjera të fituara gjatë procesit të kalimit të furnizuesit vetëm për këtë qëllim.

Së bashku me kërkesën e përmendur në pikën 2 të nenit 6, klienti duhet t'i bashkëngjisë një konfirmim me shkrim furnizuesit, në dy kopje, të

lëshuara për qëllime të procesit të ndryshimit të furnizuesit, jo më herët se shtatë ditë pas dorëzimit të kërkesës, ku të jetë konfirmuar se ai i ka shlyer detyrimet e ndërsjella financiare, në përputhje me kontratën e shitjes, në ditën e shpalljes së falimentit të furnizuesit aktual.

7.4 Brenda tri ditëve nga paraqitja e kërkesës për furnizimin nga furnizuesi i mundësisë së fundit, ky i fundit do të lidhë një kontratë furnizimi me një klient, e cila hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet në ditën e ndryshimit të furnizuesit. Brenda tri ditëve, furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të informojë operatorin e sistemit për këtë.

7.5 Jo më vonë se tetë ditë pas paraqitjes së njoftimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, operatori i sistemit është i detyruar të ofrojë të dhëna matëse për pikën e matjes dhe informon furnizuesin e mundësisë së fundit dhe klientin.

Pa përjashtim, të dhënat e matjes duhet të përfshijnë datën në të cilën ato lidhen dhe kjo datë do të konsiderohet si data e ndryshimit të furnizuesit.

Neni 8

Ndryshimi i furnizuesit në rastet kur kontrata e shitjes ndërpritet me një klient që ka të drejtë në furnizim publik

8.1 Në rastet kur kontrata e furnizimit të gazit ndërpritet në mënyrë të njëanshme nga furnizuesi, nëse konsumatori ka të drejtë për furnizim publik, furnizuesi aktual duhet të informojë operatorin e sistemit dhe furnizuesin publik për ndërprerjen e kontratës brenda tri ditëve dhe detyrohet të vazhdojë furnizimin deri në ditën e ndryshimit të furnizuesit, në përputhje me këto rregulla.

Kur një kontratë, me afat të caktuar, lidhet me një klient sipas pikës 8.1, paragrafi 1 i këtij neni, brenda një afati jo më të gjatë se 15 ditë, jo më vonë se tetë ditë përpara ditës së përfundimit të kontratës së shitjes, furnizuesi aktual është i detyruar ta informojë operatorin e sistemit për faktin se furnizimi do të ndërpritet te klienti me përfundimin e kontratës.

8.2 Brenda tetë ditësh pas marrjes së njoftimit për ndërprerjen e kontratës të referuar në pikën 8.1, paragrafi 1 të këtij neni, operatori i sistemit duhet të ofrojë të dhëna matëse për pikën e matjes dhe të informojë klientin, furnizuesin



aktual dhe të ngarkuarin me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit. Të dhënat e matjes duhet të përfshijnë datën së cilës ata i referohen dhe kjo datë do të konsiderohet si data e ndryshimit të furnizuesit.

Brenda tetë ditësh pas pranimit të njoftimit të referuar në pikën 8.1, paragrafi 2, të këtij neni, operatori i sistemit duhet të ofrojë të dhëna matëse për pikën e matjes, për ditën kur kontrata është ndërprerë dhe do të informojë klientin, furnizuesin aktual dhe furnizuesin publik për ditën që do të konsiderohet të jetë dita e ndryshimit të furnizuesit.

8.3 Në rast të falimentimit, likuidimit, ndërprerjes, anulimit, revokimit të përhershëm të licencës së furnizuesit aktual të klientit që ka të drejtë në furnizim publik, do të zbatohen dispozitat e dhëna në pikat 7.1 dhe 7.2 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Ndryshimi i furnizuesit në rast të përfundimit të kontratës së shitjes, për shkak të mospagesës

Për pikën matëse të një klienti, kontrata e furnizimit e të cilit është ndërprerë për shkak të detyrimeve të pashlyera sipas kontratës së shitjes, pas dorëzimit të njoftimit të furnizuesit për ndërprerjen e kontratës për shkak të borxhit efektiv të pashlyer, operatori i sistemit duhet të ofrojë të dhënat e matjes në ditën e përfundimit të kontratës, kur operatori do të ndalojë shpërndarjen në pikën e shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Furnizuesi i cili ka ndërprerë kontratën e shitjes sipas këtij neni konsiderohet furnizuesi aktual.

Neni 10

Detyrimet e një furnizuesi të ri, të furnizuesit kontrata e të cilit është ndërprerë dhe të operatorit të sistemit

10.1 Furnizuesi i ri i gazit natyror duhet të sigurojë akses në kapacitetet në pikën e daljes nga sistemi i transmetimit me qëllim dërgimin e gazit natyror te klienti i ri, pika e dorëzimit të të cilit është brenda sistemit të transmetimit.

Pas përfundimit të kontratës së shitjes së gazit natyror me klientin, objekti i të cilit është i lidhur me sistemin e shpërndarjes, furnizuesi i ri duhet të dorëzojë një listë të azhurnuar të klientëve tek operatori i sistemit, si dhe të dhënat mbi shitjet e kontraktuara të gazit natyror për klientin e ri në operatorin e sistemit të transmetimit.

Nëse operatori i sistemit të transmetimit përcakton nevojën për të harmonizuar kontratat ekzistuese të transmetimit, ai duhet të informojë operatorin e sistemit të shpërndarjes para ditës kur furnizuesi është lidhur në formë të shkruar dhe fton furnizuesin aktual dhe atë të ri për të harmonizuar kontratat ekzistuese të transmetimit.

10.2 Nëse klienti kërkon lëshimin e konfirmimit të përmendur në pikën 6.4 të kësaj rregulloreje dhe detyrimet e ndërsjella në aspektin e furnizimit nuk janë rakorduar ndërmjet furnizuesit aktual dhe konsumatorit, furnizuesi aktual duhet të lëshojë një konfirmim për detyrimet e përgjithshme të pashlyera ndaj konsumatorëve.

10.3 Jo më vonë se tri ditë pas ndryshimit të furnizuesit, operatori i sistemit do të azhurnojë bazën e të dhënave për furnizuesin e ri dhe për pikën e dërgimit, për të cilat është bërë ndryshimi i furnizuesit.

Pas azhurnimit të të dhënave, sipas paragrafit 2 të këtij neni, pa vonesë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes njofton Operatorin e Sistemit të Transmetimit për këtë. Ky njoftim duhet të përfshijë në mënyrë të veçantë të dhënat, për: klientin, pikën e dërgimit (numrin e identifikimit të pikës së matjes nga pikat matëse në sistemin e shpërndarjes dhe të dhëna të tjera në pikën e dërgimit), furnizuesit dhe balancuesit.

Operatori i sistemit do të përditësojë regjistrin e përgjegjësisë së balancimit mbështetur në legjislacionin në fuqi (rregullat e tregut dhe kodet).

PJESA II

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendimin e bordit të ERE-s.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Këto rregulla do të hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM****Nr. 24, datë 30.1.2018****MBI MIRATIMIN E LICENCËS TIP TË
AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË GAZIT
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 22 dhe 23, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e licencës tip të aktivitetit të tregtimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 163, datë 12.10.2017, ERE ka filluar procedurën për miratimin e licencës tip të tregtimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 100/52 prot., datë 17.10.2017, ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës tip të tregtimit të gazit natyror, duke ftuar palët e interesit të shprehin komentet apo sugjerimet mbi këtë draft.

- Me shkresën nr. 684 prot., datë 20.10.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Autoriteti i Konkurrencës, shoqëria Albgaz sh.a. dhe shoqëria

Albpetrol sh.a. Draftlicenca tip e tregtimit të gazit natyror, është përcjellë elektronikisht edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për komente.

- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët, rezultoi se mbi këtë draftlicencë tip, janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, komentet e të cilëve janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE në draftlicencë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën tip të aktivitetit të tregtimit të gazit natyror (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**LICENCË
PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Numri i licencës: _____

Certifikata e regjistrimit: _____

Seria: _____

Data e hyrjes në fuqi: _____

Licenca i jepet: _____

Shogëria: _____

NUIS: _____

Kohëzgjatja: _____

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në seksionin e dytë të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë tregtimi (licenca), për të kryer aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, personit të lartpërmendur, i quajtur (i licencuari), subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej ____ vjetësh, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

[Kryetari]
[Vula e ERE-s]



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**KUSHTET E LICENCËS
PËR
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Numri i licencës: _____

I jepet: _____
(emri i plotë i të licencuarit)

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas ligjit dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të kësaj licence.

2. Nëse ndonjë kusht i kësaj licence pushon së qeni efektiv, ai kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura do të vazhdojnë të jenë në fuqi.

3. Kjo licencë nuk do t’i transferohet, tërësisht ose pjesërisht, asnjë personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të ERE-s. Kur miraton një transferim, ERE mund ta modifikojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës pasi të ketë arsyetuar vendimarrjen.

4. ERE ndryshon licencën në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe parashikimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, në rastet e mëposhtme:

- a) me iniciativën e vet;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) kur ndryshojnë kushtet, për të cilat është dhënë licenca;
- d) me kërkesën e të licencuarit.

5. I licencuari mund të kërkojë një modifikim të kësaj licence nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim, si dhe dokumentacionit mbështetës, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

6. I licencuari mund t’i parashtrojë ERE-s një kërkesë me shkrim për rinovimin e licencës, jo më pak se 3 muaj para përfundimit të afatit të licencës së dhënë.

Përkufizimet e termave të përcaktuar në:

- Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

- “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017;

- “Rregulloren mbi procedurat e heqjes së licencave në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017;

- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016;

- Rregullat dhe rregulloret që i përkasin sektorit të gazit natyror (legjislacioni në fuqi), përfshihen në këtë licencë për çdo qëllim.

Fjalë dhe fraza të tjera të përdorura në këtë licencë dhe në kushtet e licencës, të cilat nuk përfshihen në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë vijnë:

- a) “Biznes i lidhur” do të thotë çdo biznes; i cili
- b) direkt ose indirekt, plotësisht ose pjesërisht, zotërohet nga i licencuari;
- c) ka të drejta pronësie mbi të licencuarin; ose
- d) është pronë e një personi, i cili është pronë e të licencuarit.

e) “Ndërsubvencionime” do të thotë transferimi i fondeve ose ndarje e kostove ndër llogaritë e të licencuarit ose llogaritë e bizneseve të lidhura me qëllim mbështetjen financiare të një aktiviteti apo biznesi, duke i kaluar kostot të një aktiviteti apo biznesi tjetër.



f) “Aktivitet i licencuar” do të thotë aktivitetet e lidhura direkt dhe të nevojshme për aktivitetin e tregtimit dhe ndërveprimin me sistemet e tjera të transmetimit, në përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi.

g) “I licencuar”, sikurse përdorur në këtë dokument, do të thotë personi i përmendur në faqen e parë të kësaj licence, i cili zotëron lejen e marrë nga ERE për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

h) “Procedurat e licencimit për sektorin e gazit natyror” do të thotë procedura e parashikuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

i) “Rregullat dhe rregulloret” do të thotë të gjitha standardet, kodet, rregullat, rregulloret, metodologjitë dhe çdo vendim ose akt tjetër në fuqi, të miratuara nga ERE dhe autoritete të tjera ligjvënëse.

j) “Informacion me ndjeshmëri tregtare” do të thotë të dhëna në lidhje me biznesin ose me natyrë tregtare, që zotërohen nga i licencuari gjatë procesit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, të cilat duhet të mbahen konfidenciale.

k) “Informacion me avantazh tregtar”, do të thotë informacion i lidhur me aktivitetin e vetë të licencuarit, i cili duhet të mbahet konfidencial dhe nuk duhet t’i jepet apo t’u bëhet i ditur të tjerëve në mënyrë diskriminuese.

l) “Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si: tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi ta shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

m) “Operim” është vënia në veprim dhe shfrytëzim, në kuptimin tregtar, të infrastrukturës së sistemit të gazit natyror, në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE.

n) “Pagesa rregullatore” është pagesa vjetore, që shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror paguajnë në ERE, për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij, në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE.

o) “Tregtar i gazit” është një shoqëri që kryen veprimtari të tregtisë së gazit, si një veprimtari tregu, e pajisur me licencë për ta ushtruar këtë veprimtari.

p) “Tregtia e gazit” është shitblerja e gazit natyror, duke përjashtuar shitjen e tij te klienti fundor.

q) “Tregu primar” është tregu i shitblerjes së kapaciteteve drejtpërdrejt nga OST-ja ose Operatori i Sistemit të Depozitimit të GNL-së.

r) “Treg sekondar” është tregu ku tregtohen kapacitetet, përveç kapaciteteve të tregtueshme në tregun primar.

s) “Tregtim” është blerja ose shitja me shumicë e gazit natyror.

t) “Operator i Sistemit të Transmetimit (OST)” është personi juridik që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit.

Neni 2

Kryerja e aktivitetit të licencuar

1. I licencuari autorizohet nga kjo licencë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.

2. I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë lidhur me veprimtarinë e licencuar në dëm të tregtuesve, furnizuesve ose klientëve dhe përdoruesve ekzistues ose të mundshëm.

3. I licencuari nuk do të angazhohet në kryerjen e veprimeve ose në ndonjë aktivitet tjetër që përbën sjellje antikonkurruese sipas legjislacionit në fuqi.

4. I licencuari nuk do të angazhohet në veprimtari të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen si duhet të veprimtarisë së licencuar. I licencuari do të njoftojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë veprimtari, përveç veprimtarisë së licencuar.



5. I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuar të tjerë apo konkurrues potencialë që të angazhohen ligjërisht ose të hyjnë në biznesin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

6. Gjithë marrëveshjet e shitblerjes së gazit natyror duhet të përputhen me legjislacionin në fuqi për aq sa kërkohet nga këto të fundit.

7. Të gjitha marrëveshjet do të jenë objekt monitorimi nga ERE për të siguruar funksionimin e tregut dhe që të licencuarit nuk ushtrojnë ndikim mbi tregun, duke ndjekur praktika të padrejta dhe që bien ndesh me legjislacionin për konkurrencën.

Neni 3

Detyrimet e të licencuarit

1. I licencuari do të respektojë legjislacionin në fuqi gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kësaj licence.

2. I licencuari do të ndërmarrë masat e nevojshme për garantimin e aftësive teknike dhe financiare për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

3. I licencuari do të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të gazit natyror pranë operatorit të tregut të gazit natyror, sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ERE-s.

4. I licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tij në përfitim të klientëve dhe të sektorit të gazit natyror.

5. I licencuari do të përmbushë gjithë rregullat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të miratuara nga ERE, përfshirë zbatimin e gjithë urdhrave operativë, udhëzimeve, si dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër, sipas kërkesave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror dhe rregullave të tregut të gazit natyror.

Neni 4

Llogaritë dhe raportimi

1. I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare konform legjislacionit në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. I licencuari do t'i dorëzojë ERE-s

bilancet financiare vjetore së bashku me raportet e auditit brenda datës 31 mars të çdo viti. I licencuari mban llogari të veçanta financiare për veprimtari të tjera të gazit, të cilat mund të jenë të konsoliduara, duke mbajtur të ndara edhe llogaritë që nuk lidhen me veprimtarinë e parashikuara në këtë ligj.

2. Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s më 31 janar të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, që përmban sa më poshtë:

a) një përmbledhje dhe analizë të operimit në veprimtarinë e licencuar;

b) sasinë e gazit të tregtuar, si dhe çmimin e blerjes dhe të shitjes së tij;

c) çdo ndërprerje të veprimtarisë, si dhe përshkrim të arsyeve të ndërprerjes;

d) një përmbledhje dhe analizë të kontratave të lidhura për shitblerjen e gazit natyror në fuqi dhe gjatë vitit që raportohet.

3. I licencuari do t'i paraqesë ERE-s, me kërkesën e saj dhe sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERE, çdo informacion që është i domosdoshëm për ERE-n për të kryer përgjegjësitë e saj rregullatore të autorizuara.

4. I licencuari do të vërë në dispozicion të ERE-s, ministrisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse, të dhënat përkatëse, për një periudhë të paktën 5 vjet, në lidhje me të gjitha transaksionet, në kontratat e tregtimit me gaz dhe derivativëve të tij, me klientët me shumicë, OST-në, operatorët e sistemit të depozitimit dhe të sistemit të GNL-së.

5. Këto të dhëna vihen në dispozicion edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë po për të njëjtën periudhë.

6. Të dhënat duhet të përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si: kohëzgjatja, rregullat e ofertës dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sasinë, datat, kohën e ekzekutimit të kontratës, çmimet e transaksionit, mjetet e identifikimit të klientëve me shumicë të përfshirë, si dhe detaje për të gjitha kontratat e papaguara.

7. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga i licencuari, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.

8. I licencuari do ta njoftojë ERE-n, brenda 10 ditëve për çdo ndryshim, të:



- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) NUIS-in;
- e) drejtuesve të lartë.

9. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, petitionet, deklaratat ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me detyrimet sipas kësaj licence duhet të jenë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar të autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose të ERE-s. Këto dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit. Do të konsiderohen të pranuar edhe gjithë njoftimet e dërguara përmes postës elektronike zyrtare të komunikuar më parë nga palët.

Neni 5

Përdorimi i informacionit

1. Sipas ligjit, Kodit të Transmetimit, Kodit të Shpërndarjes, “Rregullave të tregut të gazit natyror” dhe kërkesave të rregulloreve përkatëse, i licencuari do të sigurojë që, çdo informacion i marrë nga të tjerët si rezultat i veprimtarisë së tij të licencuar, nuk do t’i jepet askujt, përveç rasteve kur:

- a) ka pëlqimin paraprak me shkrim të personit me çështjet e të cilit lidhet informacioni;
- b) informacioni është tashmë i njohur për publikun;
- c) kur të licencuarit i kërkohet ose i lejohet ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, çdo urdhër të ERE-s dhe legjislacionit në fuqi.

2. Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta mbrojtur informacionin konfidencial që posedon dhe do t’i paraqesë ERE-s raporte që lidhen me respektimin e detyrimeve të parashikuara në nenin 7.

3. Informacioni që i sigurohet ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik, përveç kur me kërkesë të veçantë të të licencuarit, ERE, me vendim, siguron se ky informacion është i natyrës pasurore dhe se interesi publik të cilit i shërbehet nga përhapja e tij, nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin komercial potencial ndaj të licencuarit.

Neni 6

Pagesat e rregullimit

1. I licencuari do të paguajë pagesën e rregullimit në mënyrën e përcaktuar nga ERE gjatë afatit të kësaj licence, në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda afatit të kërkuar nga ERE, ndaj të licencuarit do të merret masë administrative, në përputhje me nenin 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 7

Kontrolli mbi performancën e veprimtarisë së licencuar

1. ERE do të monitorojë respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të licencuarit.

2. Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të licencuarit për të inspektuar veprimtarinë e licencuar sipas rregullave të ERE-s. I licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.

3. Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim administrativ për respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës ose rregullave të ERE-s.

4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka respektuar kushtet e licencës, ERE mundet të ndërmarrë masa të tjera brenda autoritetit të saj, me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj licence.

5. I licencuari do ta informojë dhe do ta sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

6. I licencuari do t’u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi.



Neni 8

Vendosja e masave administrative dhe heqja e licencës

1. Nëse i licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.

2. ERE mund të heqë licencën në përputhje me nenin 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Neni 9

Heqja e licencës

1. ERE heq një licencë kur i licencuari:

- a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës;
- b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
- d) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;
- e) bëhet financiarisht i paafte ose kërkon shpalljen e falimentimit;
- f) me kërkesë të të licencuarit;
- g) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

2. Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari kryesor/ortaku që kontrollojnë interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizim nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, sipas “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

3. Kjo licencë mund të transferohet vetëm me vendim me shkrim të ERE-s dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ERE. Çdo vendim i ERE-s për ndonjë transferim të kësaj licence do të jetë objekt i gjykimit të ERE-s, nëse personi të cilit i transferohet licenca do të ketë aftësinë teknike dhe financiare për të plotësuar afatet dhe kushtet e kësaj licence.

4. Çdo transferim i kësaj licence, pa miratimin e ERE-s, do të anulohet dhe do të përbëjë një shkelje të kësaj licence.

5. Kur licenca përfundon si pasojë e shkeljeve nga i licencuari të kushteve të licencës, i licencuari do të përgjigjet për koston që i shkakton ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut si rezultat i këtij përfundimi, siç përcaktohet nga ERE, përfshirë kostot lidhur me transferimin e rregullt të licencës të një i licencuar i ri.

6. Kur ERE përcakton se i licencuari ka shkelur një ose më shumë kushte të licencës, të licencuarit do t'i jepet një mundësi e arsyeshme për ta korrigjuar shkeljen para përfundimit të licencës, përveç kur shkelja përfshin korrupsion ose pandershmëri të vërtetuara nga organet me autoritetin përkatës, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 10

Situatat e emergjencës

1. I licencuari nuk do të konsiderohet se ka shkelur kushtet e kësaj licence në rast se parandalohet në përmbushjen e tyre nga forca madhore ose rrethana të tjera emergjence.

2. Në kushtet e emergjencës, i licencuari:

a) do të sigurojë bashkëpunimin e nevojshëm me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për të vepruar në situatë emergjence, me qëllim që të rifillojë veprimtarinë brenda një periudhe kohore sa më të shkurtër;

b) do të plotësojë detyrimet e tij për reduktimin e rreziqeve dhe humbjeve lidhur me jetën, shëndetin dhe pronën e palëve të treta;

c) Brenda 24 orëve nga ngjarja e emergjencës, i licencuari do të njoftojë ERE-n për situatën e emergjencës dhe veprimet që do të ndërmerren për të rifilluar veprimtarinë normale.

3. Nëse i licencuari e parashikon situatën e emergjencës siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 24 orëve dhe ky njoftim do të përshkruajë se çfarë hapash do të marrë i licencuari për të menjnuar ose për të përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuar.



Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apel

1. Çdo çështje e diskutueshme ose pretendim mes të licencuarit dhe çdo pjesëmarrësi në treg lidhur me kushtet e licencës dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim midis palëve, në bazë të kërkesës së një prej palëve në mosmarrëveshje, ERE do ta zgjidhë

mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Çdo palë në konflikt mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

4. Subjektet e licencuara do të zbatojnë vendimet e ERE-s, deri në një vendim gjykatë të formës së prerë.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË****LICENCË
PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Licenca i jepet:

(emri i plotë i të licencuarit)

Seria: _____ Nr. i licencës: _____

Data e hyrjes në fuqi të kësaj shtojce: _____

**VENDIM****Nr. 25, datë 30.1.2018****MBI MIRATIMIN E LICENCËS TIP NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 22 dhe 23, të ligjit nr. 102 /2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e licencës tip të furnizimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 162, datë 12.10.2017, ERE ka filluar procedurat për miratimin e licencës së furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 100/52 prot., datë 17.10.2017, ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës së furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 684 prot., datë 20.10.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Autoriteti i Konkurrencës, shoqëria Albgaz sh.a. dhe shoqëria Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë elektronikisht edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët, rezultoi se mbi këtë draftlicencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, komentet e të cilëve janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE në draftlicencë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën tip të aktivitetit të furnizimit të gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCË
PËR
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Numri i licencës: _____

Certifikata e regjistrimit: _____

Seria: _____

Data e hyrjes në fuqi: _____

Licenca i jepet: _____

Shogëria: _____

NUIS: _____

Kohëzgjatja: _____

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë (licenca), për të kryer veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (FGN), personit të lartpërmendur, i quajtur (i licencuari), subjekt i kushteve të licencës të bashkangjitura dhe pjesë integrale të saj, si dhe kushteve të përcaktuara nga bordi në vendimin e tij, nëse ka.

Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi, deri në përfundim të afatit të dhënë në rast se nuk hiqet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu apo parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

KRYETAR I ERE-s



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**KUSHTET E LICENCËS
PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT
TË GAZIT NATYROR**

Seria: _____

Numri i licencës: _____

I jepet: _____

(emri i plotë i të licencuarit)

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në kreun III, seksionin I, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, për të lëshuar dhe për të deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1. Nëse ndonjë kusht i kësaj licence bëhet nul ose i anulueshëm apo pushon së qeni në fuqi, ky kusht do të hiqet nga licenca dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

2. Në rastet e transferimit të licencës, i licencuari ka detyrimin të njoftojë menjëherë ERE-n.

3. ERE ka të drejtën ekskluzive për të modifikuar këtë licencë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar, si dhe për të përmbushur dispozitat e rregullave për organizimin e tregut të gazit natyror; ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, “Kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror”; Kodit të Rrjetit të Transmetimit; Kodit të Rrjetit të Shpërndarjes; Kodit të Matjes; dhe/ose akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ERE, në zbatim të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Përkufizimet e termave të përcaktuar në:

- Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

- “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017;

- “Rregulloren mbi procedurat e heqjes së licencave në sektorët e energjisë elektrike dhe të

gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017;

- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016;

- Rregullat dhe rregulloret që i përkasin sektorit të gazit natyror (legjislacioni në fuqi) përfshihen në këtë licencë për çdo qëllim.

Fjalë dhe fraza të tjera, të përdorura në këtë licencë dhe në kushtet e licencës, të cilat nuk përfshihen në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë vijojnë:

- “Ndërsubvencionime” do të thotë transferimi i fondeve ose ndarje e kostove ndër llogaritë e të licencuarit ose llogaritë me qëllim mbështetjen financiare të një aktiviteti apo biznesi, përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror nga të ardhurat e fituara nga i licencuari që kryen aktivitetin e licencuar ose duke i kaluar kostot të shkaktuara nga i licencuari gjatë kryerjes së aktivitetit të licencuar të një aktiviteti apo biznesi tjetër, përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror.

- “Aktivitet i licencuar” do të thotë aktivitetet e lidhura direkt dhe të nevojshme për furnizimin me gaz natyror, që do të thotë shitja dhe rishitja e gazit natyror për konsumatorët, në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, rregullat për organizimin e tregut të gazit natyror, kushtet e përgjithshme për furnizimin me gaz natyror, si dhe rregullat dhe rregulloret e tjera që aplikohen.

- “I licencuar”, sikurse përdorur në këtë dokument, do të thotë personi i përmendur në faqen e parë të kësaj licence, që mban licencën e lëshuar nga ERE, për kryerjen e aktivitetit të licencuar.



- “Procedurat e licencimit për sektorin e gazit natyror”, do të thotë procedura e parashikuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- “Legjislacioni në fuqi” do të thotë të gjitha standardet, kodet, rregullat, rregulloret, metodologjitë dhe çdo vendim ose akt tjetër në fuqi, të miratuara nga ERE dhe autoritete të tjera kompetente, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- “Informacion me ndjeshmëri tregtare” do të thotë të dhëna në lidhje me biznesin ose me natyrë tregtare të përdoruesve të sistemit, që zotërohen nga i licencuari gjatë procesit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, të cilat duhet të mbahen konfidenciale.

- “Informacion me avantazh tregtar” do të thotë informacion i lidhur me aktivitetin e vetë të licencuarit, i cili duhet të mbahet konfidencial dhe nuk duhet t’i jepet apo t’u bëhet i ditur të tjerëve në mënyrë diskriminuese.

- “Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si: tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi ta shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

- “Pagesa rregullatore” është pagesa vjetore që shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror paguajnë në ERE për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij, në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE.

Neni 2

Kryerja e aktivitetit të licencuar

1. I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të zhvilluar aktivitetin e furnizuesit të gazit natyror sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria e gazit natyror, që është licencuar për veprimtarinë e furnizimit me gaz

natyror, ka të drejtë të kryejë edhe veprimtarinë e prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror, me kusht që të mbajë llogari të ndara për secilën veprimtari, siç përcaktohet në nenin 30, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. I licencuari duhet të ofrojë shërbimet e tij që kanë lidhje me aktivitetin e licencuar me çmime tregu që nuk janë të rregulluara sipas një kontrate për furnizimin me gaz natyror të negociuar midis të licencuarit dhe konsumatorëve të tij, sipas nenit 93 (kontrata standarde) ose 95 (kontrata FMF), të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror dhe rregullave dhe rregulloreve që aplikohen, përveç rasteve të parashikuara në kushtet e licencës.

3. Në rastet kur i licencuari përcaktohet të ofrojë furnizim me gaz natyror të mundësisë së fundit, sipas neneve 90 dhe 91, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe/ose të ofrojë furnizimin me gaz natyror sipas detyrimeve të shërbimit publik, sipas nenit 92, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe ky furnizim, bazuar në vendimet përkatëse të ERE-s, ofrohet me çmime të rregulluara, i licencuari nuk duhet të vendosë pagesa për konsumatorët e tij, të cilët përfitojnë nga furnizimi i mundësisë së fundit ose furnizimi sipas detyrimeve publike, përveç atyre çmimeve (tarifave) të rregulluara, të miratuara nga ERE, bazuar në metodologjitë e miratuara nga ERE, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

4. I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të ndalojë të licencuarit e tjerë ose pjesëmarrësit potencialë ose konkurrentët që të angazhohen ose të hyjnë në biznesin e furnizimit apo në aktivitete të tjera në sektorin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

5. I licencuari nuk do të përfshihet në asnjë formë aktiviteti monopol ose antikonkurrencë të ndaluar nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës.

6. I licencuari nuk duhet të angazhohet në ndonjë aktivitet që ka lidhje me transmetimin, shpërndarjen dhe/ose depozitimin e gazit natyror, si dhe me transmetimin dhe/ose shpërndarjen e energjisë elektrike.



7. Brenda datës 31 janar të çdo viti, i licencuari do t'i dërgojë ERE-s një informacion dhe deklaratë me shkrim për kryerjen e aktivitetit gjatë vitit paraardhës dhe përmbushjes së kuadrit ligjor në sektorin e gazit natyror, sipas kërkesave raportimit të vendosura nga ERE, sipas nenit 16, pika 24, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

8. I licencuari nuk do të bashkëpunojë me persona të tjerë për të dëmtuar interesat e të licencuarve ose klientëve të gazit natyror.

9. I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e transparencës, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi

10. I licencuari që do të angazhohet në aktivitete të tjera të ndryshme nga aktiviteti për të cilin është licencuar, duhet të informojë ERE-n në rastet kur synon të:

a) angazhohet në aktivitete tjetër përveç aktivitetit të licencuar; ose

b) të ngrejë një biznes shoqërues.

11. ERE mund ta ndalojë angazhimin në një aktivitet tjetër ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e bizneseve shoqëruese të nevojshme për të mbrojtur interesat e klientëve.

12. I licencuari nuk është përgjegjës për mospërmbushjen e kushteve të licencës në rast të një force madhore, deri në atë shkallë sa forca madhore është shkaku për këtë mospërmbushje të kushteve të licencës. Në këtë rast, i licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të licencuarit e tjerë ose klientët me të cilët i licencuari ka lidhur marrëveshje.

13. I licencuari duhet ta rivendosë ofrimin e shërbimeve të ndërprera, sipas kushteve dhe afateve të vendosura të kushtet e përgjithshme për furnizimin me gaz natyror, si dhe rregullave dhe rregulloreve që zbatohen dhe kontratës së gazit natyror.

Neni 3

Detyrimet e të licencuarit

1. I licencuari është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe gjithë vendimet e Këshillit të Ministrave dhe rregulloret e rregullat e miratuara nga ERE.

2. Furnizuesi, në zbatim të kësaj licence, ka detyrimin të furnizojë klientët me gaz natyror, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

3. Kontratat e furnizimit me gaz natyror duhet të përcaktohen dhe të finalizohen sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror. Në mënyrë të veçantë, i licencuari duhet:

a) të finalizojë kontratat e furnizimit me gaz natyror me konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla, në formën e miratuar nga ERE, si kërkohet sipas nenit 93, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

b) të caktojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me gaz natyror me konsumatorët e tjerë, si kërkohet, sipas nenit 95, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

4. Furnizuesi informon klientët e tij, për:

a) të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të gazit natyror, sipas nenit 76, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe rregullave të miratuara nga ERE për ndryshimin e furnizuesit, si dhe kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror;

b) konsumin dhe kostot aktuale të gazit natyror, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të gazit natyror nga ana e klientëve;

c) mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;

d) mundësinë e përdorimit të procedurave të thjeshta për ndjekjen e ankesave të tyre;

e) ndryshimin e kushteve të kontratës, të paktën 15 ditë përpara zbatimit të tyre, duke përfshirë informacionin në lidhje me të drejtën e klientëve për të zgjedhur në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit, me dhënien e njoftimit;

f) të dhënat e konsumit të tij, duke i mundësuar çdo klienti akses në leximin e aparatit të matjes dhe ndaj të dhënave të matjes, në bazë të një marrëveshjeje të qartë dhe pa pagesë;

g) informacion tjetër i cili kërkohet të ofrohet nga furnizuesi për konsumatorët, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kushtet e përgjithshme për furnizimin me gaz natyror dhe kontratën e furnizimit me gaz natyror.

5. Furnizuesit, nëpërmjet faturës së konsumit të gazit natyror dhe/apo materialeve promovuese, informon në mënyrë të qartë klientët, për:



- a) konsumin faktik të gazit natyror;
- b) të dhëna për çdo burim gazi të siguruar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm;
- c) elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse;

d) të dhënat për ndikimin në mjedis të gazit karbonik dhe mbeturinave radioaktive të emetuara gjatë prodhimit të gazit natyror, të siguruar nga furnizuesi në vitin e mëparshëm;

e) mjetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave;

f) informacioni tjetër që kërkohet të jepet te faturat e furnizuesit, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror dhe kontratën e furnizimit me gaz natyror.

6. Sipas nenit 90, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i licencuari mund të caktohet si furnizues i mundësisë së fundit me gaz natyror. Në këtë rast, përveç detyrimeve që kryen sipas aktivitetit të licencuar, i licencuari duhet të kryejë funksionet e furnizuesit të mundësisë së fundit me gaz natyror dhe duhet të kryejë detyrat e përcaktuara në nenet 90 dhe 91, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kushtet e përgjithshme për furnizimin me gaz natyror, rregullat e funksionimit të miratuara nga ERE për furnizuesin e mundësisë së fundit dhe rregulloret dhe rregullat e tjera që aplikohen. I licencuari i ngarkuar sipas ligjit me detyrimin për sigurimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror, u siguron klientëve dhe ndërmarrjeve të gazit natyror të dhëna mbi tregun e gazit natyror, konsumin e gazit natyror, duke i publikuar njëkohësisht këto të dhëna, të cilat janë të vlefshme për operatorët e tregut.

7. Sipas nenit 92, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i licencuari mund të caktohet si furnizues i gazit natyror sipas detyrimeve të shërbimit publik. Në këtë rast, përveç detyrimeve të tij në kryerjen e aktivitetit të licencuar, i licencuari duhet të kryejë funksionet e furnizuesit të gazit natyror sipas detyrimeve të shërbimit publik dhe duhet të kryejë detyrat e vendosura, sipas nenit 92, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror, rregullave të funksionimit të miratuara nga ERE për furnizuesin me gaz natyror, sipas detyrimeve të shërbimit publik dhe rregullave dhe rregulloreve të tjera që aplikohen.

8. Në rastet kur i licencuari përcaktohet si furnizues i mundësisë së fundit për gazin natyror, siç përshkruhet në paragrafin 2,3 të kushteve të kësaj licence, dhe/ose si furnizues i gazit natyror, sipas detyrimeve të shërbimit publik, ka të drejtë të furnizojë gaz natyror në kushtet e tregut dhe pa kufizim territorial, me kusht që të mbajë llogari të ndara për secilën prej veprimtarive siç janë. Aktiviteti i licencuar, i kryer sipas kushteve të tregut, furnizimi i mundësisë së fundit me gaz natyror dhe/ose furnizimi me gaz natyror, sipas detyrimeve të shërbimit publik, si kërkohet sipas paragrafit 4 të kushteve të kësaj licence.

9. I licencuari është i detyruar të ngrejë qendrën e kujdesit të klientit, e cila duhet të japë informacion, të trajtojë pyetjet, kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve fundorë, që bëhen me anë të *email*-it, telefonit ose duke u paraqitur personalisht. I licencuari duhet të përshtatë oraret zyrtare të qendrës së kujdesit të klientit sipas nevojave të konsumatorëve fundorë, duke siguruar që të paktën një ditë në javë kjo qendër të qëndrojë e hapur deri në orën 20:00. Duhet të jepet mundësia që konsumatorët fundorë të kontaktojnë me qendrën e kujdesit të klientit me anë të telefonit ose *e-mail*-it.

10. I licencuari duhet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të tij fundorë, si dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve fundorë, duke përfshirë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pa gjyq, në mënyrë eficiente dhe pa pagesë. I licencuari duhet t'i sigurojë konsumatorëve fundorë të kenë të drejtën e një standardi të mirë shërbimi dhe që ankesat e tyre janë trajtuar siç duhet dhe në mënyrë të tillë që të mundësojnë zgjidhjen e drejtë dhe të duhur të mosmarrëveshjeve, mundësisht brenda dy (2) javëve, me ofrimin në rast se garantohej, të një sistemi rimbursimi dhe/ose kompensimi.

11. I licencuari duhet të kryejë detyrat e tjera të përcaktuara sipas fushës së veprimtarisë së licencuar, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, rregullat për organizimin e tregut të gazit natyror, kushtet e përgjithshme për furnizimin me gaz natyror, rregullat dhe rregulloret e tjera që aplikohen dhe kushtet e kësaj licence.



Neni 4

Llogaritë dhe raportimi

1. I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara) ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Kur është e nevojshme dhe sipas kushteve të përcaktuara të rregullat dhe rregulloret që aplikohen, këto llogari mund të ofrohen në një formë të konsoliduar. I licencuari do t’i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore deri në datën 31 mars të çdo viti. Nëse i licencuari ushtron më shumë se një aktivitet, faturat e shpenzimeve për çdo aktivitet që ushtron, duhet të jenë lehtësisht të dallueshme se cilit aktivitet i përkasin, me shenja dalluese të qarta sipas përkatësisë së aktivitetit të licencuar për të cilin janë përdorur. Në çdo rast të tillë, i licencuari duhet t’i deklarojë ERE-s mënyrën e identifikimit të secilës faturë.

2. I licencuari do të vërë në dispozicion të ERE-s, ministrisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse të dhënat përkatëse, për një periudhë, të paktën 5 vjet, në lidhje me të gjitha transaksionet, në kontratat e furnizimit me gaz dhe derivativëve të tij, me klientët me shumicë, OST-në, operatorët e sistemit të depozitimit dhe të sistemit të GNL-së, si kërkohet sipas nenit 77, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Këto të dhëna vihen në dispozicion edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, po për të njëjtën periudhë.

3. Të dhënat duhet të përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si:

- a) kohëzgjatja;
- b) rregullat e ofertës dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- c) sasinë, datat;
- d) kohën e ekzekutimit të kontratës;
- e) çmimet e transaksionit;
- f) mjetet e identifikimit të klientëve me shumicë të përfshirë;
- g) detaje për të gjitha kontratat e papaguara, për furnizim me gaz dhe derivatëve të tij.

4. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga i licencuari, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.

5. Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose për të përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuar.

6. I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe tipave të tjerë të aktiviteteve, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do t’i paraqesë ERE-s, me kërkesën e tij, në formën dhe në afatin e vendosur nga ERE, dokumentacionin që vendos bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta mes aktiviteteve që do të ushtrohen, si dhe rezultatet e arritura pas kësaj ndarjeje.

7. I licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) NUIS-it
- e) organeve kryesore drejtuese; ose
- f) strukturës së biznesit të licencuar.

8. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me licencën duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues ligjor i caktuar i të licencuarit ose ERE-s, dhe të dërgohet me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit, ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

9. I licencuari do të dërgojë në ERE informacion periodik, lidhur me:

- a) shpenzimet dhe të ardhurat operative (mujore dhe në progresion 3-mujor);
- b) pasqyra *Cash-Flow* (mujore dhe progresive);
- c) tabela e të dhënave mbi gazin natyror të furnizuar (mujore dhe progresive);



d) çdo informacion të kërkuar rast pas rasti nga ERE;

e) numrin e klientëve të furnizuar (mujore dhe progresive);

f) grafikët e ngarkesës;

g) sistemet e matjes;

h) të dhëna mbi ankesat e regjistruara, trajtimin dhe korrigjimet në faturimet përkatëse objekt ankimi (mujore dhe progresive);

i) Kërkohet informacion tjetër sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe kërkesave të raportimit të miratuara nga ERE, sipas nenit 16, pika 24, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 5

Përdorimi i informacionit

1. I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

a) jepet pëlqim paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;

b) informacioni është bërë publik;

c) kur të licencuarit i kërkohet ose i lejohej të përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, sipas një urdhri të ERE-s ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme;

d) informacioni duhet përhapur në funksion të kryerjes së aktivitetit të licencuar.

2. I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion të ndonjë person tjetër (përfshirë biznese të tjera shoqëruese) që mund ta mundësojnë këtë person të fitojë çdo lloj përfitimi komercial të pajustificuar.

3. Çdo informacion me avantazh tregtar në zotërim të të licencuarit duhet të shpërndahet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese dhe duhet të aksesohet lehtësisht dhe në mënyrë të barabartë nga konsumatorët aktualë dhe të mundshëm dhe palët e tjera të interesuara. Shpërndarja e informacionit me avantazh tregtar duhet të përpunohet për të parandaluar trajtimet preferenciale të konsumatorëve individualë, pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror ose palëve të tjera të interesuara, në lidhje me

fushëveprimin, përmbajtjen dhe/ose formën e informacionit të shpërndarë dhe/ose kohën kur ai është shpërndarë.

4. I licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur konfidencial informacionin në posedim të tij dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me detyrimet ligjore, sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror dhe kontratën e furnizimit me gaz natyror.

5. Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE, me vendim, përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

6. ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të marrë nga i licencuari, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara të rregulloret dhe rregullat që aplikohen sipas neneve 16, pika 15, dhe 20, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

7. I licencuari nuk do të hyjë në marrëveshje të cilat i licencuari e di ose duhet ta dijë që çojnë në shkelje të kushteve të licencës.

8. I licencuari do të respektojë ligjet dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret e rregullat e ERE-s.

Neni 6

Pagesat e rregullimit

1. I licencuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence, siç përcaktohet nga ERE në rregulloren për pagesat e rregullimit, si dhe nenin 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda afatit të përcaktuar nga ERE, i licencuari do të penalizohet në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregulloren mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 95, datë 4.7.2017.



Neni 7

Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar

1. ERE do të monitorojë respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të licencuarit. Për këtë qëllim, ERE, ndër të tjera, duhet të ketë akses të pakufizuar te llogaritë e të licencuarit, sipas neneve 30 dhe 31, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të licencuarit për të inspektuar veprimtarinë e licencuar, sipas rregullave të ERE-s. I licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.

3. Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim administrativ për respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës ose rregullave të ERE-s.

4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka respektuar kushtet e licencës, ERE mundet të ndër marrë masa të tjera brenda autoritetit të saj me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj licence.

5. I licencuari do ta informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

6. I licencuari do t’u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Amendimi i licencës

1. ERE mund të ndryshojë/shfuqizojë kushtet e licencës në rast se ato nuk përputhen, me:

a) legjislacionin në fuqi dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) vendimet e nxjerra nga një gjykatë shqiptare me kompetencë juridiksionale.

2. Në çdo kohë i licencuari mund t’i propozojë ERE-s ndryshime të tjera të kushteve të kësaj licence, duke paraqitur një propozim me shkrim, së bashku me dokumentet mbështetëse. ERE mund të propozojë ndryshime të kushteve të kësaj licence e t’i konsultojë ato me palët e interesit përpara miratimit.

3. ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e klientëve dhe të të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo ndryshim të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto ndryshime, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

4. Të gjitha ndryshimet të kushteve të licencës duhet të kryhen nga ERE, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, procedurës së licencimit për sektorin e gazit natyror dhe rregulloreve dhe rregullave të tjera që aplikohen.

5. Amendamentet e bëra në kushtet e licencës do të publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë

Neni 9

Vendosja e masave administrative dhe heqja e licencës

1. Nëse i licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe “Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.

2. ERE mund të heqë licencën, në përputhje me nenin 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Neni 10

Heqja e licencës

1. ERE heq një licencë kur i licencuari:

a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës;

b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;



d) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;

e) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;

f) me kërkesë të të licencuarit;

g) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

2. Licenca mund të hiqet nga ERE sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara të ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, procedurave të licencimit për sektorin e gazit natyror, rregullores mbi procedurat e refuzimit të licencës në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe rregullave dhe rregulloreve të tjera që aplikohen.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apelim

1. Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo pjesëmarrësi tregu do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE, në bazë të kërkesës së çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje, do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij, në përputhje me nenin 98, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga konsumatorët dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

3. I licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë.

VENDIM

Nr. 26, datë 30.1.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ENERGJI ASHTA SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “d”; të nenit 5, pika 1, germa “d”; të nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimit funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë Energji Ashta sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 714 prot., datë 2.11.2017, shoqëria Energji Ashta sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për licencim në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

- Subjekti, me shkresën (plotësim dokumentacioni) të protokolluar në ERE me nr. 714/2 prot., datë 12.12.2017, ka depozituar statutin e ndryshuar dhe ekstraktin e shoqërisë, që bën me dije se objekti i veprimtarisë së shoqërisë ka ndryshuar, duke shtuar në të aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, i cili nuk ka qenë i pasqyruar në dokumentacionin e aplikimit nr. 714 prot., datë 2.11.2017.

- Me vendimin nr. 205, datë 18.12.2017, ERE ka filluar procedurat për licencimin e shoqërisë Energji Ashta sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë Energji Ashta sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Energji Ashta sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 27, datë 30.1.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË HEC LLËNGË SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA: HEC LLËNGA 1, ME FUQI 1730 kw; HEC LLËNGA 2, ME FUQI 300 kw; DHE HEC LLËNGA 3, ME FUQI 1500 kw, ME FUQI TOTALE 3530 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”; 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen

e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: Llënga 1, Llënga 2 dhe Llënga 3, me fuqi totale të instaluar 3530 kw, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria HEC Llëngë sh.p.k., me shkresën nr. 692 prot. të ERE-s, datë 30.10.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga: HEC Llënga 1, me fuqi 1730 kw; HEC Llënga 2, me fuqi 300 kw; HEC Llënga 3, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 198, datë 24.11.2017, vendosi për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Llëngë.

- Shoqëria HEC Llëngë sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1, të kontratës koncesionare, datë 24.9.2012, të lidhur ndërmjet shoqërisë Istria Sviluppo s.r.l., me cilësinë e koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e autoritetit kontraktues, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 26.5.2010, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC Llëngë.

- Ortak i vetëm i shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. rezulton të jetë shoqëria Energjia Ekologjike sh.p.k., me 100% të kuotave, referuar kjo kontratës noteriale me nr. 420 rep. dhe nr. 221 kol., datë 15.10.2012, të “Shitblerjes së kuotave”. Në përmbushje të detyrimeve të kontratës së sipërpërmendur, shoqëria Istria Sviluppo s.r.l., me cilësinë e ortakut të vetëm, në datën 24.9.2012, ka krijuar shoqërinë koncesionare HEC Llëngë sh.p.k., Me qëllim tjetërsimin e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë koncesionare, në respektim të ligjit për koncesionet dhe të kontratës së koncesionit më sipër cituar, pala shitëse është



pajisur me miratimin e transferimit të aksioneve nga ana e autoritetit kontraktues (METE), me shkresën nr. 935/28 prot., datë 5.10.2012. Me vendimin e datës 10.10.2012 të ortakut të vetëm të shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. është vendosur transferimi i 100% të kuotave të kapitalit themeltar që shoqëria Istria Sviluppo s.r.l. zotëron te shoqëria HEC Llëngë sh.p.k., te blerësi Energjia Ekologjike sh.p.k. Në nenin 4 të saj theksohet se: “Shoqëria Istria Sviluppo s.r.l. e humb të drejtën e zotërimit të këtyre kuotave, e drejtë që fitohet nga shoqëria Energjia Ekologjike sh.p.k.”.

- METE, me shkresën nr. 935/28 prot., datë 5.10.2012, drejtuar shoqërisë koncensionare HEC Llëngë sh.p.k., sqaron se miratojmë transferimin e aksioneve në masën 100% me anë të shitblerjes, me kushtin që të ruhet emri i koncensionarit, si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e koncensionit midis METE-s dhe koncensionarit, të cilat i takojnë shoqërisë Istria Sviluppo s.r.l., në të kundërt marrëveshja është e pavlefshme.

Sa më sipër, konfirmimi i njohjes si shoqëri koncensionare të shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. rezulton e konsideruar nga autoriteti kontraktues (METE), në shkresën me nr. 935/28 prot., datë 5.10.2012, me lëndë “Miratim transferim aksionesh”, drejtuar shoqërisë koncensionare HEC Llëngë sh.p.k.

Aplikimi i shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5, germa “a” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Mund të veçojmë këtu shkresën e OSHEE sh.a., “Miratim pike lidhjeje HEC Llëngë sh.p.k.”, me nr. 2740/3 prot., datë 9.3.2017, drejtuar shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k.

- Vendimi nr. 4/7, datë 19.12.2017, i Këshillit Kombëtar të Ujit, për miratimin në parim të lejes së përdorimit të ujit dhe ngarkimi i AUB-së Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi, drejtuar shoqërisë HEC Llëngë sh.p.k.

- Rezulton e miratuar në parim (neni 9, pika 4.1.5, germa “b”) leja e përdorimit të ujit nga Këshilli Kombëtar të Ujit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë HEC Llëngë sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga: HEC Llënga 1, me fuqi 1730 kw; HEC Llënga 2, me fuqi 300 kw; HEC Llënga 3, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw.

2. Shoqëria HEC Llëngë sh.p.k. të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të lejes së ujit para vënies në operim të veprës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 28, datë 30.1.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË LUÇENTE
KONCESIONARE SHPK, PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC SPATHARË,
ME FUQI 1038 kw**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë



elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Luçente Koncesionare sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Spatharë, me fuqi 1038 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 11 prot., datë 9.1.2018, shoqëria Luçente Koncesionare sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC Spatharë, me fuqi 1038 kw.

- Nga analiza e bërë dokumentacionit të paraqitur në këtë aplikim rezulton, se shoqëria Luçente Koncesionare sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4, 4.4.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 7, pika 2, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, gjerat “a” (prokurën e aplikuesit për përfaqësimin e tij) dhe “b” (vërtetim që i deleguari përgjegjës nuk është përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë, vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

- Nenin 8, pika 3 (dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar, ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit).

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetim që personi dhe drejtuesit kryesorë të tij në rastin e personave juridikë nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

- Nenin 9, pika 2, germa “f” (marrëveshja e koncesionit, mungesa e faqes së fundit të saj me nënshkrimet e palëve);

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Luçente Koncesionare sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Spatharë, me fuqi të instaluar 1038 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 29, datë 30.1.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË REJ ENERGY SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME NR. 177, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 120, DATË 29.8.2012**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë Rej Energy sh.p.k., përparatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria Rej Energy sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: Cemerica 1, me fuqi të instaluar 0.88 mw; Cemerica 2, me fuqi të instaluar 0.9 mw; Cemerica 3, me fuqi të instaluar 2.1 mw, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012.

Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria Rej Energy sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”, “Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës”, plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “b”, “Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence”, plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “c”, “Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës, kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera”, pa plotësuar. Nuk është paraqitur miratimi i projektit të rritjes së fuqisë nga autoritetit kontraktues.

- Neni 15, pika 4, germa “d”, “Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi”, plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “e”, “Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE”, plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4, germa “c”, do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë Rej Energy sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012, me nr. 177, seria PV12K, për “Prodhimin e energjisë elektrike”, nga HEC-et: Cemerica 1, me fuqi të instaluar 0.88 mw; Cemerica 2, me fuqi të instaluar 0.9 mw; Cemerica 3, me fuqi të instaluar 2.1 mw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë